



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 54, datë 29.03 2016

**PËR
MIRATIMIN E TARIFËS MUJORE PËR MBËSHTETJEN E OPERATORËVE PRIVAT VENDOR
PËR NJË ALLOTMENT, NË RRJETIN NUMERIK TË NDËRTUAR NGA RTSH**

Në mbështetje të nenit 122, pika 3, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA),

VËREN SE:

Strategjia për kalimin në transmetimet numerike përcakton metodologjinë për llogaritjen e pagesave të operatorëve ekzistues analogë për mbështetje në rrjetin e TVSH. Për këtë çështje, AMA ka ofruar ndihmë dhe sugjerime, në takime të drejtpërdrejta me RTSH si dhe në mbledhjet e Sekretariatit Teknik. Pavarësisht kësaj, është në kompetencë të RTSh-së për të përcaktuar tarifën për shërbimet që do t'u ofrojnë operatorëve ekzistues analogë, të cilat do të miratohen më pas nga AMA.

Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike ka parashikuar që tarifa e mbështetjes së operatorëve analogë vendorë në rrjetin numerik të RTSh, të përcaktohet duke u bazuar në kostot e ndërtimit të rrjetit. Sipas llogaritjes së zërave përkatës, tarifa për mbështetjen në rrjetin e RTSh-së rezultoi në vlerën prej 2,880 (dymijë e tetëqind e tetëdhjetë) Euro/Muaj për allotment.

Gjatë vitit 2015, nga RTSH janë propozuar disa tarifa, por që nuk kanë qenë të aprovuara nga Bordi Drejtues i RTSh-së. Gjithsesi, bazuar dhe në studime që AMA ka kryer mbi nivelin aktual të pagesave për infrastrukturën transmetuese me të cilat operojnë në treg operatorët analogë vendorë, ka rezultuar se këto tarifa kanë qenë të larta. Një fakt i këtyre sjell pengesa në mbarëvajtjen e procesit të mbylljes së transmetimeve analoge, pasi përball operatorët lokale vendore me peshë financiare të lartë dhe të paparashikuar, në një moment kur mbyllja e transmetimeve analoge dhe kalimi në transmetimet numerike është detyrim ligjor.

Në qershor të vitit 2015, AMA organizoi një takim konsultativ me operatorët televizivë lokalë dhe rajonalë me fokus kryesor problematikat e mbështetjes së operatorëve në rrjetin e RTSH-së, si dhe për llogaritjen e tarifave përkatëse gjatë procesit të digjitalizimit, ku u theksua rëndësia për të pasur një proces transparent dhe të bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në Strategjinë kombëtare të kalimit të transmetimeve nga analogu në numerik, duke sjellë një produkt cilësor për publikun dhe me kosto sa më të ulët.

Mbas një sërë takimesh dypalëshe midis AMA-s dhe RTSh-së u ra dakord edhe rishikimi i metodologjisë së për llogaritjes së tarifës së mbështetjes. Në këtë mënyrë u përcaktua që metodologjia e për llogaritjes së tarifës të konsideronte vetëm zërat financiarë që lidhen me mirëmbajtjen e rrjetin numerik dhe jo të ndërtimit të tij. Ky propozim gjeti dhe miratimin e Komitetit Ndërinstitucional për zbatimin e Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike.

Në muajin Janar 2016, Bordi i RTSH miratoi tarifën e mbështetjes së operatorëve analogë në rrjetin numerik, tarifë kjo që rezultoi në vlerën prej **1,073 (një mijë e shtatëdhjetë) Euro/MWh** për Allotment. Përlllogaritja e tarifës është kryer duke marrë në konsideratë vetëm zërat financiarë të mirëmbajtjes së njërit prej dy rrjeteve numerike, i cili do të shërbejë për mbështetjen e transmetimeve të operatorëve analogë vendorë.

Në vijim, nga AMA, me shkresën nr. 234/1 prot., datë 09.02.2016, u kërkuar depozitimi i dokumentacionit të nevojshëm justifikues, për zërat financiarë të vlerësuar prej tyre në hartimin e kësaj tarife, përpara miratimit të saj, sipas tre pikave si më poshtë:

1. **Kontrolli i rregullshmërisë financiare** - Tërësia e dokumentacionit që vërteton ruajtjen e burimeve dhe të pasurive si dhe siguron saktësinë dhe plotësinë e regjistrave kontabël.
2. **Kontrolli i rregullshmërisë së përputhshmërisë** - Referenca e kuadrit rregullator mbi të cilën vërtetohet zbatimi i ligjeve.
3. **Kontrolli i drejtimit dhe performancës** - Vlerësimi i vendimmarrjes së menaxhimit të burimeve sipas ekonomizimit, efijencës dhe efektivitetit, si dhe zbatimi i politikave referuese të administrimit mbi nxjerrjen e një informacioni të besueshëm ekonomiko-financiar.

RTSH me shkresën nr. 234/2 prot., datë 17.03.2016, depozitoi në AMA dokumentacionin mbështetës për masat e shpenzimeve të vlerësuara prej tyre në hartimin e tarifës, si më poshtë:

1. **Lidhur më kontrollin e rregullshmërisë financiare – RTSH ka paraqitur dokumentacionin justifikues për zërat si më poshtë;**

a. **Shpenzimet për energji elektrike.**

Në përcaktimin e këtij zëri, RTSH ka depozituar informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Stacioneve të RTSh-së mbi shpenzimet për vitet 2014 dhe 2015, për 11 (njëmbëdhjetë) stacionet që aktualisht janë në punë. Shpenzimet e përcaktuara për vitin 2015 janë shoqëruar me faturat mujore të OSHEE-së për çdo pikë transmetimi. Nga kontrolli i kryer për disa nga këto pika, shuma e vlerësuar në total përkon me faturat justifikuese të bashkangjitura. Nga ana e saj, RTSh sqaron se kostot e energjisë elektrike për stacionet e reja të parashikuara në projektin e ndërtimit të MUX-eve janë bërë në bazë të një konsumi të pritshëm sipas kapacitetit të pajisjeve të reja. Gjithashtu, RTSh bën me dije se, për derisa këto pajisje janë të reja, kosto e saktë e këtij zëri do mund të përcaktohet vetëm pasi ato të vihen në punë. Lidhur me çmimin e zbatuar për kë/orë, RTSh ka paraqitur vendimin e ERE-s, nr. 148, datë 26.12.2014, ku përcaktohen çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015.

Zëri i mësipërm është përlllogaritur bazuar në fuqinë e instaluar për transmetues (gjithsej 59 stacione) dhe fuqinë e instaluar të ajrit të kondicionuar. Në total kosto e këtij zëri është vlerësuar në masën **423,984 euro në vit.**

b. **Shpenzimet për karburant.**

Shpenzimi i karburantit është përlllogaritur bazuar në shpenzimet e RTSh-së për disa zona problematike ku mungesa e energjisë elektrike dikton përdorimin e gjeneratorit, i cili shoqërohet me konsum të lëndës djegëse.

Lidhur me shpenzimet e këtij zëri RTSh ka paraqitur aktet e kontrollit dhe proces verbalet e mbajtura për vitin 2014, të sasisë së naftës të përdorur për motor gjeneratorët, për të gjithë stacionet ekzistuese të RTSh. Aktet rezultojnë të jenë të firmosura nga përgjegjësi i stacioneve, magazinieri, ekonomisti dhe nga përgjegjësi i sektorit elektrik. Gjithashtu RTSh ka depozituar tabelat referuese të konsumit fizik lidhur me orët e punës të gjeneratorëve, orët e ndezjes për provë etj.

Sipas analizës së paraqitur nga RTSh, janë 60 (gjashtëdhjetë) stacione problematike të cilat parashikohen të konsumojnë lëndë djegëse në vlerën **82,875 (tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) euro**.

c. Shpenzimet për furnizim me energji elektrike me Kompani celulare.

Lidhur me këtë zë RTSh ka paraqitur kontratën ekzistuese më AMC për instalimin e aparaturave të saj në Stacionet në pronësi të AMC, ku parashikohet një kosto mujore prej 40,000 lekë në muaj për site, me një vlerë totale **171,429 euro** në vit.

d. Shpenzime për qiramarrjen e stacioneve.

Lidhur me këtë zë, RTSh, për fazën e parë të ndërtimit të rrjeteve ka kryer një sondazh me operatorët ofrues të mundshëm të objekteve të nevojshme me qira, ku sipas një table të paraqitur nga RTSH me rezultatet e këtij sondazhi janë identifikuar personat ofrues të këtij shërbimi dhe çmimet e ofruara nga ta lidhur me këtë shërbim. Pagesa për qiramarrjen e siteve (22 pika transmetimi) është vlerësuar nga operatori publik në masën **85,714 euro** në vit.

2. Lidhur Me kontrollin e rregullshmërisë së përputhshmërisë - RTSH ka paraqitur dokumentacionin justifikues si më poshtë:

a. Pagesa për SLA (4 module)

Kuadri ligjor verifikues i depozituar lidhur me këtë zë është kërkesa për propozim e hartuar nga Ministria e Inovacionit, Informimit dhe Komunikimit Teknologjik të vitit 2013, në vijim të së cilës, më 19 Mars 2015, u firmos kontrata për ndërtimet e rrjeteve numerike të operatorit publik. Gjithashtu është depozituar edhe draft kontrata me kompaninë R&S, për sigurimin e shërbimit të SLA-s, për mirëmbajtjen e rrjeteve pas futjes së tyre në punë.

RTSH kërkon të sigurojë nga modulet e prezantuara në këtë draft propozim, 4 (katër) të parat, të cilat janë:

- Shërbim operativiteti;
- Shërbimi i mirëmbajtjes diagnostikuese;
- Shërbimi i mirëmbajtjes periodike;
- Shërbimi i mirëmbajtjes së emergjencës;

Gjithashtu është parashikuar edhe përfshirja e kostove të blerjes së "pajisjeve rezervë", për pajisjet kryesore që sipas kontratës janë në masën 400,000 euro.

Kosto e këtij zëri është vlerësuar në total në masën **2,200,000 euro** në vit.

Sigurimi i këtij zëri përcaktohet sipas VKM-së nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", ku në pikën 2, përcaktohet se: "Institucionet që do të zhvillojnë sisteme në fushën e teknologjisë së informimit... duhet të parashikojnë dhe hartojnë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit (Service Level Agreement – SLA)".

b. Pagesa për energji dhe karburant.

Kuadri ligjor referues për këtë zë është vendimin e ERE-s, nr. 148, datë 26.12.2014, ku përcaktohen çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015.

c. Pagesa për furnizim me energji elektrike me Kompani celulare.

Kuadri ligjor referues për këtë zë është kontrata e lidhur midis operatorit publik dhe kompanisë të telefonisë celulare lëvizëse AMC, me referencë TC/AC/005/12.

d. Pagesa për frekuencat e MWlink (AKEP).

Kuadri ligjor referues për këtë zë është VKM nr. 25, datë 14.01.2014 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.07.2010, i ndryshuar, "Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe serive numerike", si dhe udhëzimi nr. 30, datë 23.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit". RTSH përlllogarit të ketë një detyrim vjetor për 100 r/rele në masën **123,411 euro** në vit.

e. Pagesa për rojet e siteve.

Kuadri ligjor referues për këtë zë janë rekomandimet mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike, nenet 81 – 88 të Kodit të punës të RSH, ligji nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" si dhe vendimi nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor". Pagesa për rojet në site (pika transmetimi) është përlllogaritur për 70 punonjës. Kosto totale e parashikuar për këtë zë është **313,200 euro** në vit.

f. Pagesa për qiratë e siteve.

Lidhur me këtë zë është paraqitur vetëm një kontratë tip që do shërbejë për lidhjen e marrëveshjes së bashkëpunimit pas marrjen e ambienteve të reja me qira nga RTSH.

3. Lidhur më kontrollin e drejtimit dhe performancës;

RTSh deklaron se nga ana tyre është bërë vlerësim i kujdesshëm veçanërisht për kostot e mirëmbajtjes të transmetimit pas ndërtimit të rrjeteve. Nënshkrimi i një kontrate mirëmbajtjeje është vlerësuar si zgjidhja më e leverdishme ekonomiko – financiare, pasi për të paktën 4 (katër) vitet e para të funksionimit të rrjetit, stafi i brendshëm i RTSH –s nuk është i gatshëm si nga ana profesionale ashtu dhe e burimeve njerëzore për t'iu përshtatur teknologjisë së re të transmetimit numerik.

Totali i shpenzimeve të përlllogaritura sipas zërave të mësipërm për dy rrjete numerike është në masën **3,400,613 euro**. I llogaritur për një rrjet, ky zë shkon në vlerën **1,700,306 euro**.

Duke konsideruar hapësirat e transmetimit për një rrjet në 12 operatorë, në 11 allotmente, për 12 muaj, tarifa e propozuar është **1,073 euro (pa TVSH)**.

Tarifa e mësipërme është e llogaritur pa asnjë marzh fitimi për operatorin publik.

Lidhur me pagesat e diferencuara, bazuar në Strategjisë për kalimet nga transmetimet analoge në transmetimet digjitale, RTSH propozon skemën e mëposhtme:

- Për zonat e allotmentit Tiranë-Durrës tarifa do të jetë e dyfishuar: **2,146 Euro/muaj**
- Për zonat e allotmenteve Bregdet+Korçë tarifa do të jete e shumëzuar me koeficient 1.5: **1,609.5 Euro/muaj**
- Për zonat e allotmenteve të tjera tarifa do të shumëzohet me koeficient 0.5: **536.5 Euro/muaj**

Kjo metodologji është argumentuar në Strategjinë për kalimin në transmetimet numerike, si vijon:

Pika 7.7.1, faqe 67:Pagesë e diferencuar sipas zonës së licencimit:"Dihet së zonat e licencimit të operatorëve televizivë nuk paraqesin të njëjtën tërheqje për biznesin. Zonat më atraktive janë zona Tiranë – Durrës , Ultësira Perëndimore e Shqipërisë dhe zona Korçë – Elbasan. Zonat e tjera konsiderohen

të vështira. Ky diferencim duhet të reflektohet edhe në pagesat për mbështetjen në platformat numerike...”

AMA në datën 19.02.2016, në kuadër të sigurimit të mbështetjes së operatorëve analogë privatë vendorë në rrjetet numerike si dhe pas miratimit të tarifës nga RTSH për sigurimin e kësaj mbështetjeje në rrjetin e operatorit publik, në muajin Shkurt 2016, organizoi takimin e radhës me operatorët analogë vendorë.

Gjatë këtij takimi, operatorët shprehën shqetësimet e tyre lidhur me tarifën dhe metodologjinë e ndjekur për përcaktimin e pagesave të diferencuara të kësaj pagese. Subjektet u shprehën se vlerat e koeficienteve të zbatuar sipas zonave të ndryshme, nuk përbënin bazë të drejtë vlerësimi.

Gjatë analizave lidhur me pagesat e diferencuara, konsiderohet e përshtatshme që metodologjia e përcaktimit të tarifave të diferencuara të mbështetjet në numrin e popullsisë në çdo allotment, si kriter më i përafërt i parashikimit të mbarëvajtjes së biznesit, mbështetur në shikueshmërinë e reklamave televizive. Gjatë përlogaritjes së tarifave të diferencuara mbështetur në këtë metodologji, rezulton se tarifa për allotmentin Tirane-Durrësshton në 3,981 Euro/Muaj. Kjo tarifë rezulton tepër e lartë për t'u përballuar nga të gjithë operatorët vendorë që transmetojnë në këtë allotment. Si rrjedhojë propozohet që për allotmentin Tirane-Durrës të zbatohet tarifa e propozuar nga RTSH. Propozohet që diferenca midis tarifës së rezultuar dhe tarifës së propozuar nga RTSH, prej 1,835 Euro, të shpërndahet në allotmente e tjera në mënyre proporcionale mbështetur në numrin e popullsisë së çdo allotmenti.

Për rrjedhojë, për gjithë sa më sipër:

- Meqenëse informacioni financiar i paraqitur nga RTSH lidhur me zërat e vlerësuar në përcaktimin e tarifës për mbështetjen e operatorëve vendorë lokalë në një allotment, është parashikim i mbështetur në kostot e rrjetit ekzistues analog,
- Duke pasur parasysh që RTSH ende nuk e ka nënshkruar kontratën për SLA-n (zëri i kostove për mirëmbajtjen e rrjeteve nga kompania ndërtuese),
- Meqenëse kriter më i përafërt i parashikimit të mbarëvajtjes së biznesit, mbështetur në shikueshmërinë e reklamave televizive është numri i popullsisë për çdo allotment,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, bazuar në nenin 122, pika 3, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës mujore për mbështetjen e operatorëve vendorë lokale për një allotment në rrjetin e RTSH-së, në vlerën 1,073 euro/muaj pa përfshirë TVSH.
2. Tarifa mujore për mbështetjen në një allotment, do zbatohet për jo më shumë se 1 (një) vit, afat ky që fillon nga hyrja në fuqi e këtij vendimi me të drejtë rishikimi pas përfundimit të këtij afati.
3. AMA do të shprehet me vendim për miratimin e tarifës për vitet pasardhëse, duke u bazuar në vlerësimin e zërave financiarë që do të pasqyrohen në situatën reale të operimit të rrjetit numerik tokësor gjatë vitit të parë, specifikisht zëri i shërbimit të SLA-s, për mirëmbajtjen e rrjeteve.

4. Ndarja e diferencuar e tarifës mujore do të aplikohet sipas tabelës të mëposhtme:

Nr.	Allotmenti	Tarifa e diferencuar (në euro/muaj)
1	Shkodër	1113
2	Kukës	365
3	Dibër	598
4	Lezhë	725
5	Tiranë/Durrës	2146
6	Elbasan	1473
7	Fier	1665
8	Berat	775
9	Korçë	1164
10	Gjirokastrë	512
11	Vlorë	1268

Totali: 11,803

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Gledis

GJIPALI

Piro

MISHA

Suela

MUSTA

Zylyftar

BREGU